



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 30

Tiranë – E mërkurë, 23 shkurt 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 13/2022, datë 3.2.2022	Për ratifikimin e konventës 190 “Konventa për dhunën dhe ngacmimin”, të Organizatës Ndërkombëtare të punës, 1986..... 3553
Dekret i Presidentit nr. 13486, datë 21.2.2022	Për shpallje ligji..... 3561
Vendim i Kuvendit nr. 14/2022, datë 17.2.2022	Për rrëzimin e listës së dytë në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”..... 3561
Vendim i Kuvendit nr. 15/2022, datë 17.2.2022	Për rrëzimin e listës së dytë në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”..... 3562
Vendim i Kuvendit nr. 16/2022, datë 17.2.2022	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit të Mediave Audiovizive..... 3562
Vendim i Kuvendit nr. 17/2022, datë 17.2.2022	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit të Mediave Audiovizive..... 3562
Vendim i Kuvendit nr. 18/2022, datë 17.2.2022	Për zgjedhjen e një Anëtari të Autoritetit të Mediave Audiovizive..... 3563
Vendim i Kuvendit nr. 19/2022, datë 17.2. 2022	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit të Mediave Audiovizive..... 3563
Vendim i Kuvendit nr. 20/2022, datë 17.2.2022	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit të Mediave Audiovizive..... 3563

Vendim i Kuvendit nr. 21/2022, datë 17.2.2022	Për zgjedhjen e një anëtari të Autoritetit të Mediave Audiovizive.....	3563
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6, datë 3.2.2022	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 3743, datë 10.7.2017, “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.....	3564
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 7, datë 3.2.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar.....	3564
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 30, datë 15.2.2022	Për delegim kompetencash.....	3565
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 21.10.2021	Kërkesa nr. 28142/17, “Çështja Laçi kundër Shqipërisë”	3566
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 13.1.2022	Kërkesa nr. 7469/17, “MR-Internacional sh.p.k. kundër Shqipërisë”	3576



LIGJ
Nr. 13/2022

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS 190
“KONVENTA PËR DHUNËN
DHE NGACMIMIN”, TË ORGANIZATËS
NDËRKOMBËTARE TË PUNËS, 1986

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa 190 “Konventa për dhunën dhe ngacmimin”, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, 1986, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 3.2.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13486, datë 21.2.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

C190 – KONVENTA PËR DHUNËN DHE
NGACMIMIN, 2019 (NR. 190)

Preambulë

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,

E mbledhur në Gjenevë nga Organi Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe takuar në Sesionin e 108-të (njëqindvjetor), më 10 qershor 2019 dhe

Duke rikujtuar se Deklarata e Filadelfias konfirmon se të gjitha qeniet njerëzore, pavarësisht racës, besimit ose gjinisë, kanë të drejtë të ndjekin mirëqenien e tyre materiale dhe zhvillimin e tyre

shpirtëror në kushtet e lirisë dhe dinjitetit, sigurisë ekonomike dhe mundësive të barabarta, dhe

Duke konfirmuar rëndësinë e Konventave themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe

Duke rikujtuar instrumente të tjera ndërkombëtare të rëndësishme, të tilla si: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, dhe

Duke pranuar të drejtën e gjithsecilit për një botë pune pa dhunë dhe ngacmim, duke përfshirë dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore, dhe

Duke pranuar se dhuna dhe ngacmimi në botën e punës mund të përbëjnë shkelje ose abuzim të të drejtave të njeriut, dhe se dhuna dhe ngacmimi janë një kërcënim ndaj mundësive të barabarta, janë të papranueshme dhe të papajtueshme me punën e denjë, dhe

Duke pranuar rëndësinë e një kulture pune, bazuar në respektin dhe dinjitetin e ndërsjellë të qenieve njerëzore, për të parandaluar dhunën dhe ngacmimin, dhe

Duke rikujtuar se anëtarët kanë një përgjegjësi të rëndësishme për të nxitur një mjedis të përgjithshëm me zero tolerancë ndaj dhunës dhe ngacmimit, në mënyrë që të lehtësojnë parandalimin e këtyre sjelljeve dhe praktikave, dhe se të gjithë aktorët në botën e punës duhet të përmbahen, shmangin dhe trajtojnë dhunën dhe ngacmimin, dhe

Duke pranuar se dhuna dhe ngacmimi në botën e punës ndikojnë në shëndetin psikologjik, fizik dhe seksual, dinjitetin dhe mjedisin familjar dhe shoqëror të një personi, dhe

Duke pranuar që dhuna dhe ngacmimi ndikojnë gjithashtu në cilësinë e shërbimeve publike dhe private, dhe mund të pengojnë që personat, veçanërisht gratë, të kenë akses, të qëndrojnë dhe të përparojnë në tregun e punës, dhe

Duke vërejtur se dhuna dhe ngacmimi janë të papajtueshme me promovimin e ndërmarrjeve të



qëndrueshme dhe ndikojnë negativisht në organizimin e punës, marrëdhëniet në vendin e punës, angazhimin e punëtorëve, reputacionin e ndërmarrjes dhe produktivitetin, dhe

Duke pranuar që dhuna dhe ngacmimi me bazë gjinore ndikojnë në mënyrë disproporcionale te gratë dhe vajzat, dhe duke pranuar se një qasje gjithëpërfshirëse, e integruar dhe me përgjegjësi gjinorë, e cila trajton shkaqet themelore dhe faktorët e rrezikut, duke përfshirë stereotipat gjinore, format e shumta dhe kryqëzuese të diskriminimit, dhe marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit me bazë gjinore, janë thelbësore për t'i dhënë fund dhunës dhe ngacmimit në botën e punës, dhe

Duke vërejtur se dhuna në familje mund të ndikojë në punësimin, produktivitetin dhe shëndetin dhe sigurinë, dhe se qeveritë, organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve dhe institucionet e tregut të punës mund të ndihmojnë, si pjesë e masave të tjera, për të njohur, reaguuar ndaj dhe trajtuar ndikimet e dhunës në familje, dhe

Pasi vendosi mbi miratimin e propozimeve të caktuara, në lidhje me dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, e cila është pika e pestë në rendin e ditës të sesionit, dhe

Pasi përcaktoi se këto propozime do të marrin formën e një Konvente ndërkombëtare,

miraton sot, më njëzet e një qershor të vitit dy mijë e nëntëmbëdhjetë, Konventën e mëposhtme, e cila mund të citohet si Konventa e Dhunës dhe Ngacmimit, 2019:

I. PËRKUFIZIMET

Neni 1

1. Për qëllim të kësaj Konvente:

a) termi “dhunë dhe ngacmim” në botën e punës i referohet një game sjelljesh dhe praktikash të papranueshme ose kërcënimeve të tyre, qoftë një ndodhi e vetme ose e përsëritur, të cilat synojnë, shkaktojnë ose mund të shkaktojnë dëm fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik dhe përfshin dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore;

b) termi “dhunë dhe ngacmim me bazë gjinore” nënkupton dhunën dhe ngacmimin ndaj personave për shkak të seksit ose gjinisë së tyre ose që prekin në mënyrë disproporcionale personat e një seksi

ose gjinie të veçantë, dhe përfshin ngacmimin seksual.

2. Pa cenuar nënparagrafët “a” dhe “b” të paragrafit 1, të këtij neni, përkufizimet në ligjet dhe rregulloret kombëtare mund të parashikojnë një koncept të vetëm ose koncepte të ndara.

II. OBJEKTI

Neni 2

1. Kjo Konventë mbron punëtorët dhe personat e tjerë në botën e punës, duke përfshirë punonjësit, siç përcaktohen në legjislacionin dhe praktikën kombëtare, si dhe personat që punojnë pavarësisht nga statusi i tyre kontraktues, personat në trajnim, duke përfshirë praktikantët dhe fillestarët, punëtorët, punësimi i të cilëve ka përfunduar, vullnetarë, punëkërkues dhe aplikantë për punë dhe individë që ushtrojnë autoritetin, detyrat ose përgjegjësitë e një punëdhënësi.

2. Kjo Konventë zbatohet për të gjithë sektorët, qoftë privatë apo publikë, si në ekonominë formale, edhe në atë joformale, dhe qoftë në zonat urbane apo rurale.

Neni 3

Kjo Konventë zbatohet për dhunën dhe ngacmimin në botën e punës që ndodhin gjatë, në lidhje me ose që lindin nga puna:

a) në vendin e punës, duke përfshirë hapësirat publike dhe private, kur ato janë një vend pune;

b) në vendet ku punonjësi paguhet, bën një pushim ose konsumon një vakt ose përdor ambiente sanitare, larjeje dhe ndërimi;

c) gjatë udhëtimeve të lidhura me punën, udhëtimeve, trajnimeve, eventeve ose aktiviteteve shoqërore;

d) nëpërmjet komunikimeve në lidhje me punën, duke përfshirë ato që mundësohen nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit;

e) në akomodimin e siguruar nga punëdhënësi; dhe

f) kur udhëtohet për në dhe nga puna.



III. PARIMET THEMELORE

Neni 4

1.1. Çdo anëtar që ratifikon këtë Konventë, respekton, promovon dhe realizon të drejtën e gjithsecilit për një botë pune pa dhunë dhe ngacmim.

2.2 Çdo anëtar miraton, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe rrethanat dhe në konsultim me organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve përfaqësues, një qasje gjithëpërfshirëse, të integruar dhe me përgjegjësi gjinore, për parandalimin dhe eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës. Një qasje e tillë duhet të marrë parasysh dhunën dhe ngacmimin që përfshin palë të treta, kur është e zbatueshme, dhe përfshin:

- a) ndalimin e dhunës dhe ngacmimit, me ligj;
- b) sigurimin se dhuna dhe ngacmimi trajtohen nga politika përkatëse;
- c) miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për të zbatuar masat për parandalimin dhe luftën kundër dhunës dhe ngacmimit;
- d) krijimin ose forcimin e mekanizmave të zbatimit dhe monitorimit;
- e) sigurimin e aksesit në mjete juridike dhe mbështetjes për viktimat;
- f) parashikimin e sanksioneve;
- g) përgatitjen e mjeteve, udhëzimeve, arsimim dhe trajnim, dhe rritjen e ndërgjegjësimit, në formate të arritshme, sipas rastit; dhe
- h) sigurimin e mjeteve efektive të inspektimit dhe hetimit të rasteve të dhunës dhe ngacmimit, duke përfshirë nëpërmjet inspektorateve të punës ose organeve të tjera kompetente.

3.3. Në miratimin dhe zbatimin e aksesit të referuar në paragrafin 2 të këtij neni, çdo anëtar njihet rolet dhe funksionet e ndryshme dhe plotësuese të qeverive dhe punëdhënësve, punëtorëve dhe organizatave të tyre përkatëse, duke marrë parasysh natyrën e ndryshme dhe shtrirjen e përgjegjësisë së tyre përkatëse.

Neni 5

Me qëllim parandalimin dhe eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës, çdo anëtar respekton, promovon dhe realizon parimet dhe të drejtat themelore në punë, përkatësisht lirinë

e shoqërimit dhe njohjen efektive të së drejtës për negociatë kolektive, eliminimin e të gjitha formave të punës me forcë ose të detyruar, heqjen efektive të punës së fëmijëve dhe eliminimin e diskriminimit në lidhje me punësimin dhe profesionin, si dhe promovimin e punës së denjë.

Neni 6

Çdo anëtar miraton ligje, rregullore dhe politika që garantojnë të drejtën për barazi dhe mos-diskriminim në punësim dhe profesion, duke përfshirë për punëtorët femra, si dhe për punëtorët dhe personat e tjerë që i përkasin një ose më shumë grupeve të prekshme ose grupeve në situata të prekshmërisë që preken në mënyrë disproporcionale nga dhuna dhe ngacmimi në botën e punës.

IV. MBROJTJA DHE PARANDALIMI

Neni 7

Pa cenuar dhe në përputhje me nenin 1, çdo anëtar miraton ligjet dhe rregulloret për të përcaktuar dhe ndaluar dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, duke përfshirë dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore.

Neni 8

Çdo anëtar merr masat e duhura për të parandaluar dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, duke përfshirë:

- a) njohjen e rolit të rëndësishëm të autoriteteve publike në rastin e punonjësve të ekonomisë joformale;
- b) identifikimin, në konsultim me organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve në fjalë dhe nëpërmjet mjeteve të tjera, sektorët ose profesionet dhe angazhimet e punës ku punëtorët dhe personat e tjerë të interesuar janë më të ekspozuar ndaj dhunës dhe ngacmimit; dhe
- c) marrjen e masave për mbrojtjen efektive të këtyre personave.

Neni 9

Çdo anëtar miraton ligje dhe rregullore që kërkojnë nga punëdhënësit të ndërmarrin hapat e



duhur në përpjesëtim me shkallën e tyre të kontrollit, për të parandaluar dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, duke përfshirë dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore, dhe veçanërisht, në masën që është e zbatueshme, për të:

a) miratuar dhe zbatuar, në konsultim me punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre, një politikë në vendin e punës për dhunën dhe ngacmimin;

b) marrë parasysh dhunën dhe ngacmimin dhe rreziqet shoqëruese psikosociale në menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë;

c) identifikuar rreziqet dhe vlerësimin e risqeve të dhunës dhe ngacmimit, me pjesëmarrjen e punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre, dhe marrë masa për parandalimin dhe kontrollin e tyre; dhe

d) siguruar punëtorët dhe personat e tjerë të interesuar me informacione dhe trajnime, në formate të arritshme, sipas rastit, për rreziqet dhe risqet e identifikuara të dhunës dhe ngacmimit, si dhe masat e ndërlidhura të parandalimit dhe mbrojtjes, duke përfshirë të drejtat dhe përgjegjësitë e punëtorëve dhe personave të tjerë të interesuar në lidhje me politikën e përmendur në nënparagrafin “a” të këtij neni.

V. ZBATIMI DHE MJETET JURIDIKE

Neni 10

1. Çdo anëtar merr masat e duhura, për të:

2.a) monitoruar dhe zbatuar ligjet dhe rregulloret kombëtare në lidhje me dhunën dhe ngacmimin në botën e punës;

3.b) siguruar akses të lehtë në mjetet e përshtatshme dhe efektive juridike dhe mekanizma dhe procedura të sigurt, të drejta dhe efektive të raportimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, në rastet e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës, të tilla si:

i) procedurat e ankesave dhe hetimeve, si dhe, kur është e nevojshme, mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në nivelin e punës;

ii) mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë vendit të punës;

iii) gjykatat ose tribunalet;

iv) mbrojtjen nga viktimizimi ose hakmarrja ndaj ankuesve, viktimave, dëshmitarëve dhe informatorëve; dhe

v) masat e ndihmës ligjore, sociale, mjekësore dhe administrative për ankuesit dhe viktimat;

4.c) mbrojtur privatësinë e atyre personave të përfshirë dhe konfidencialitetin, në masën e mundur dhe sipas rastit, duke garantuar që kërkesat për privatësi dhe konfidencialitet të mos keqpërdoren;

5.d) parashikuar sanksione, kur është e nevojshme, në rastet e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës;

6.e) siguruar që viktimat e dhunës dhe ngacmimit me bazë gjinore në botën e punës, kanë akses efektiv në mekanizmat me përgjegjësi gjinore, zgjidhjes së ankesave dhe mosmarrëveshjeve në mënyrë të sigurt dhe efektive, mbështetje, shërbime dhe mjete juridike.

7.f) njohur efektet e dhunës në familje dhe, në masën që është e zbatueshme, për të lehtësuar ndikimin e tij në botën e punës;

8.g) siguruar se punëtorët kanë të drejtë të largohen nga një situatë pune, ku ata kanë justifikimin e arsyeshëm për të besuar se paraqet një rrezik të afërt dhe serioz për jetën, shëndetin ose sigurinë për shkak të dhunës dhe ngacmimit, pa pësuar ndonjë hakmarrje ose pasoja të tjera të panevojshme, dhe detyrën për të informuar nivelin drejtues; dhe

9.h) siguruar se inspektoratet e punës dhe autoritetet e tjera përkatëse, sipas rastit, janë të autorizuar të trajtojnë dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, duke përfshirë edhe lëshimin e urdhrave që kërkojnë marrjen e masave me fuqi ekzekutuese të menjëhershme, dhe urdhra për të ndaluar punën në rastet e një rreziku të afërt për jetën, shëndetin ose sigurinë, duke iu nënshtuar çdo të drejtë për ankesë pranë një autoriteti gjyqësor ose administrativ, i cili mund të parashikohet me ligj.

VI. UDHËZIME, TRAJNIME DHE RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT

Neni 11

Çdo anëtar, në konsultim me organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve përfaqësues, synon të sigurojë që:

a) dhuna dhe ngacmimi në botën e punës trajtohen në politikat përkatëse kombëtare, siç janë ato politika që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në



punë, barazinë dhe mos-diskriminimin, dhe migracionin;

b) punëdhënësit dhe punëtorët dhe organizatat e tyre, dhe autoritetet përkatëse marrin udhëzime, burime, trajnime ose mjete të tjera, në formate të arritshme, sipas rastit, mbi dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, duke përfshirë edhe dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore; dhe

c) ndërmerren iniciativa, duke përfshirë fushatat e ndërgjegjësimit.

VII. METODAT E ZBATIMIT

Neni 12

Dispozitat e kësaj Konvente zbatohen me anë të ligjeve dhe rregulloreve kombëtare, si dhe nëpërmjet marrëveshjeve kolektive ose masave të tjera në përputhje me praktikën kombëtare, duke përfshirë zgjerimin ose përshtatjen e masave ekzistuese të sigurisë dhe shëndetit në punë, për të trajtuar dhunën dhe ngacmimin dhe zhvilluar masa specifike, në rastet kur është e nevojshme.

VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 13

Ratifikimet zyrtare të kësaj Konvente i komunikohen drejtorit të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, për regjistrim.

Neni 14

1.1 Kjo Konventë është e detyrueshme vetëm për ata anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimet e të cilëve janë regjistruar te drejtori i përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

2.2 Ajo do të hyjë në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës kur ratifikimet e dy anëtarëve janë regjistruar te drejtori i përgjithshëm.

3.3 Më pas, kjo Konventë hyn në fuqi për çdo anëtar, dymbëdhjetë muaj pas datës kur është regjistruar ratifikimi i saj.

Neni 15

1.1 Një anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë pas skadimit të dhjetë

viteve nga data kur Konventa hyn në fuqi për herë të parë, me një akt i cili i komunikohet drejtorit të përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim. Ky denoncim nuk hyn në fuqi deri një vit pas datës kur është regjistruar.

2.2 Çdo anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë dhe i cili, brenda vitit pas mbarimit të periudhës dhjetë vjeçare të përmendur në paragrafin e mësipërm, nuk ushtron të drejtën e denoncimit të parashikuar në këtë nen, është i detyruar për një periudhë tjetër dhjetë vjeçare dhe pas kësaj, mund të denoncojë këtë Konventë brenda vitit të parë të çdo periudhe të re dhjetë vjeçare, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

Neni 16

1.1 Drejtori i përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës njofton të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve që janë komunikuar nga anëtarët e Organizatës.

2.2. Kur anëtarët e Organizatës njoftohen për regjistrimin e ratifikimit të dytë që është komunikuar, drejtori i përgjithshëm tërheq vëmendjen e anëtarëve të Organizatës deri në datën kur Konventa do të hyjë në fuqi.

Neni 17

Drejtori i përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të dhënat e plota të të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve që janë regjistruar në përputhje me dispozitat të neneve të mëparshme.

Neni 18

Në momentet kur mund të çmojë të nevojshme, Organi Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës i paraqet Konferencës së Përgjithshme një raport mbi funksionimin e kësaj Konvente dhe shqyrton përshtatshmërinë e vendosjes në rendin e ditës së Konferencës, të çështjes së rishikimit të saj në mënyrë të plotë ose të pjesshme.



Neni 19

1.1. Nëse Konferenca miraton një Konventë të re që rishikon këtë Konventë, atëherë, përveç nëse Konventa e re parashikon ndryshe:

a) ratifikimi nga një anëtar i Konventës së re rishikuese, përfshin gjithashtu denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente, pavarësisht nga dispozitat e nenit 15 më lart, nëse dhe kur Konventa e re rishikuese do të ketë hyrë në fuqi;

b) që nga data kur Konventa e re rishikuese hyn në fuqi, kjo Konventë pushon së qeni e hapur për ratifikim nga anëtarët.

2.2. Në çdo rast, kjo Konventë mbetet në fuqi në formën dhe përmbajtjen e saj aktuale për ata anëtarë që e kanë ratifikuar atë, por që nuk kanë ratifikuar Konventën rishikuese.

Neni 20

Versionet në anglisht dhe frëngjisht të tekstit të kësaj Konvente janë njëloj të besueshme.

Informacion kryesor**Konventa në lidhje me eliminimin e dhunës dhe ngacmimin në botën e punës**

Miraturar: Gjenevë, sesioni i 108-të i KNP-së (21 qershor 2019)

Statusi: Instrument i përditësuar (Konventa Teknike).

R206 -Rekomandimi për Dhunën dhe Ngacmimin, 2019 (nr. 206)**Preambulë**

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,

E mbledhur në Gjenevë nga Organi Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe takuar në Sesionin e 108-të (Njëqindvjetor) më 10 qershor 2019, dhe

Pasi miratoi Konventën për Dhunën dhe Ngacmimin, 2019, dhe

Pasi vendosi mbi miratimin e propozimeve të caktuara në lidhje me dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, e cila është pika e pestë në rendin e ditës së seancës, dhe

Pasi përcaktoi se këto propozime marrin formën e një Rekomandimi që plotësojnë Konventën për Dhunën dhe Ngacmimin, 2019,

miraton sot më njëzet e një qershor të vitit dy mijë e nëntëmbëdhjetë Rekomandimin e mëposhtëm, i cili mund të citohet si Rekomandimi për Dhunën dhe Ngacmimin, 2019:

1. Dispozitat e këtij Rekomandimi plotësojnë ato të Konventës për Dhunën dhe Ngacmimin të vitit 2019 (në vijim e referuar si “Konventa”) dhe duhet të konsiderohen në lidhje me to.

I. PARIMET THEMELORE

1.2 Në miratimin dhe zbatimin e qasjes gjithëpërfshirëse, të integruar dhe të përgjegjshme për gjininë, e referuar në nenin 4, paragrafi 2 i Konventës, anëtarët duhet të trajtojnë dhunën dhe ngacmimin në botën e punës në punë dhe punësim, sigurinë dhe shëndetin në punë, ligjin për barazisë dhe mos-diskriminimin dhe në të drejtën penale, sipas rastit.

2.3 Anëtarët duhet të garantojnë se të gjithë punëtorët dhe punëdhënësit, duke përfshirë ata në sektorët, profesionet dhe angazhimet e punës që janë më të ekspozuara ndaj dhunës dhe ngacmimit, gëzojnë plotësisht lirinë e shoqërimit dhe njohjen efektive të së drejtës për negociata kolektive, në përputhje me Konventën për Lirinë e Shoqatave dhe Mbrojtjes së të Drejtës për Organizim 1948 (nr. 87) dhe Konventën e së Drejtës për t'u Organizuar dhe Negociatave Kolektive të vitit 1949 (nr. 98).

3.4 Anëtarët duhet të marrin masat e duhura për të:

a) promovuar njohjen efektive të së drejtës për negociata kolektive në të gjitha nivelet, si mjet për parandalimin dhe trajtimin e dhunës dhe ngacmimit dhe, në masën që është e mundur, lehtësimin e ndikimit të dhunës në familje në botën e punës; dhe

b) mbështetur këto negociata kolektive, nëpërmjet mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit mbi tendencat e lidhura dhe praktikat e mira në lidhje me procesin e negocimit dhe përmbajtjen e marrëveshjeve kolektive.

4.5 Anëtarët duhet të garantojnë që dispozitat mbi dhunën dhe ngacmimin në ligjet, rregulloret dhe politikat kombëtare, marrin parasysh instrumentet e barazisë dhe mos-diskriminimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, duke përfshirë Konventën për Shpërblimin e Barabartë (nr. 100) dhe Rekomandimin (nr. 90), 1951 dhe Konventën për Diskriminimin (Punësimi dhe



Profesionet) (nr. 111) dhe Rekomandimin (nr. 111), 1958, si edhe instrumente të tjera përkatëse.

II. MBROJTJA DHE PARANDALIMI

1.6 Dispozitat e sigurisë dhe shëndetit në punë mbi dhunën dhe ngacmimin në ligjet, rregulloret dhe politikat kombëtare duhet të marrin parasysh instrumentet përkatëse të sigurisë dhe shëndetit në punë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, si Konventa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 1981 (nr. 155), dhe Konventa për Kuadrin Promovues për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2006 (nr. 187).

2. Anëtarët, sipas rastit, duhet të specifikojnë në ligje dhe rregullore që punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre duhet të marrin pjesë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave në vendin e punës, të referuara në nenin 9 (a) të Konventës dhe këto politika, duhet të:

a) deklarojnë që dhuna dhe ngacmimi nuk do të tolerohen;

b) krijojnë programe për parandalimin e dhunës dhe ngacmimit me objektivat të matshme, sipas rastit;

c) specifikojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e punëtorëve dhe punëdhënësit;

d) përmbajnë informacione mbi procedurat e ankimit dhe hetimit;

e) sigurojnë që të gjitha komunikimet e brendshme dhe të jashtme që lidhen me incidentet dhunës dhe ngacmimit do të shqyrtohen sipas rregullave dhe do të veprohet siç duhet;

f) specifikojnë të drejtën e privatësisë së individëve dhe konfidencialitetit, siç përmendet

në nenin 10(c) të Konventës, duke balancuar të drejtën e punëtorëve për të qenë të ndërgjegjësuar për të gjitha rreziqet; dhe

g) përfshijnë masa për të mbrojtur ankuesit, viktimat, dëshmitarët dhe informatorët kundër viktimizimit ose hakmarrjes.

3.8 Vlerësimi i riskut në vendin e punës, i përmendur në nenin 9 (c) të Konventës, duhet të marrë parasysh faktorët që rrisin mundësinë e dhunës dhe ngacmimit, duke përfshirë rreziqet dhe risqet psikosociale. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rreziqeve dhe risqeve, që:

a) lindin nga kushtet dhe angazhimet e punës, organizimi i punës dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, sipas rastit;

b) përfshijnë palë të treta si klientët, ofruesit e shërbimeve, përdoruesit, pacientët dhe anëtarët e publikut; dhe

c) lindin nga diskriminimi, abuzimi i marrëdhënieve të pushtetit dhe normat gjinore, kulturore dhe shoqërore që mbështesin dhunën dhe ngacmimin.

4.9 Anëtarët duhet të miratojnë masa të përshtatshme për sektorët ose profesionet dhe angazhimet e punës ku ekspozimi ndaj dhunës dhe ngacmimit mund të jetë më i mundshëm, si për shembull puna gjatë natës, puna në izolim, shëndetësi, spitale, shërbime sociale, shërbime emergjente, punë shtëpiake, transport, arsim apo argëtim.

5.10 Anëtarët duhet të marrin masa legislative ose masa të tjera për të mbrojtur punëtorët migrantë, veçanërisht punëtorët migrante femra, pavarësisht nga statusi i migrantëve, në vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit, sipas rastit, nga dhuna dhe ngacmimi në botën e punës.

6.11 Në lehtësimin e kalimit nga ekonomia joformale në formale, anëtarët duhet të sigurojnë burime dhe ndihmë për punëtorët dhe punonjësit e ekonomisë joformale dhe shoqatat e tyre, për të parandaluar dhe trajtuar dhunën dhe ngacmimin në ekonominë joformale.

7.12 Anëtarët duhet të garantojnë që masat për të parandaluar dhunën dhe ngacmimin nuk duhet të shkaktojnë kufizimin e pjesëmarrjes në punë, sektorë ose profesione specifike, ose përjashtimin e tyre nga to, të femrave dhe grupeve të përmendura në nenin 6 të Konventës.

8.13 Referenca për grupet e prekshme dhe grupet në situata të prekshmërisë në nenin 6 të Konventës duhet të interpretohet në përputhje me standardet e zbatueshme ndërkombëtare të punës dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

III. ZBATIMI, MJETET JURIDIKE DHE NDIHMA

1.14 Mjetet juridike të përmendura në nenin 10 (b) të Konventës mund të përfshijnë:

a) të drejtën për të dhënë dorëheqje me kompensim;

b) rikthimin;

c) kompensimin e duhur për dëmet;

d) urdhrat që kërkojnë të merren masa me fuqi të menjëhershme ekzekutuese, për të siguruar



ndalimin e një sjelljeje të caktuar ose ndryshimin e politikave ose praktikave;

dhe

e) tarifat dhe kostot ligjore, sipas legjislacionit dhe praktikës kombëtare.

2.15 Viktimat e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës duhet të kompensohen në rastet e dëmtimit psikosocial, fizik ose ndonjë dëmtimi ose sëmundje tjetër, e cila rezulton në paaftësi për të punuar.

3.16 Mekanizmat e ankesave dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mbi dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore, të përmendura në nenin 10 (e) të Konventës, duhet të përfshijnë masa, si për shembull:

a) gjykata me ekspertizë në rastet e dhunës dhe ngacmimit me bazë gjinore;

b) përpunim në kohë dhe në mënyrë efikase;

c) këshillë dhe ndihmë juridike për ankuesit dhe viktimat;

d) udhëzues dhe burime të tjera të informacionit, të disponueshme dhe të arritshme në gjuhët që fliten gjerësisht në vend; dhe

e) kalim të barrës së provës, sipas rastit, në procese të ndryshme, përveç procedimeve penale.

4.17 Mbështetja, shërbimet dhe mjetet juridike për viktimat e dhunës dhe ngacmimit me bazë gjinore, të përmendura në nenin 10(e) të Konventës, duhet të përfshijnë masa, si për shembull:

a) mbështetje për të ndihmuar viktimat për të rihyrë në tregun e punës;

b) shërbime këshillimi dhe informacioni, në një mënyrë të arritshme, sipas rastit;

c) linja telefonike 24-orëshe;

d) shërbimet e urgjencës;

e) kujdes dhe trajtim mjekësor dhe mbështetje psikologjike;

f) qendrat e krizave, duke përfshirë strehëzat; dhe

g) njësi të specializuara policore ose oficerë të trajnuar posaçërisht për të mbështetur viktimat.

5.18 Masat e duhura për të lehtësuar ndikimet e dhunës në familje në botën e punës, të referuara në nenin 10(f) të Konventës, mund të përfshijnë:

a) lejen për viktimat e dhunës në familje;

b) angazhimet fleksibël në punë dhe mbrojtje për viktimat e dhunës në familje;

c) mbrojtjen e përkohshme kundër largimit nga puna për viktimat e dhunës në familje, sipas rastit,

përveç për arsye që nuk kanë lidhje me dhunën në familje dhe pasojat e saj;

d) përfshirjen e dhunës në familje në vlerësimet e rrezikut në vendin e punës;

e) një sistem referimi në lidhje me masat zbutëse të publikut për dhunën në familje, në rastet kur ekzistojnë; dhe

f) rritjen e ndërgjegjësimit për efektet e dhunës në familje.

6.19 Autorët e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës duhet të mbahen përgjegjës dhe të sigurohen me këshillime ose masa të tjera, sipas rastit, me qëllim parandalimin e përsëritjes së dhunës dhe ngacmimit, dhe lehtësimin e ri-integritimit të tyre në punë, kur është e nevojshme.

7.20 Inspektorët e punës dhe zyrtarët e autoriteteve të tjera kompetente, sipas rastit, duhet t'i nënshtrohen një trajnimit me përgjegjësi gjinore, me qëllim identifikimin dhe trajtimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës, duke përfshirë rreziqet dhe risqet psikosociale, dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore, dhe diskriminimin ndaj grupeve të veçanta me punëtorë.

8.21 Mandati i organeve kombëtare përgjegjëse për inspektimin e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe barazinë dhe mos-diskriminimin, duke përfshirë barazinë gjinore, duhet të mbulojë dhunën dhe ngacmimin në botën e punës.

9.22 Anëtarët duhet të bëjnë përpjekje për të mbledhur dhe publikuar statistika mbi dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, të ndara sipas gjinisë, formës së dhunës dhe ngacmimit dhe sektorit të veprimtarisë ekonomike, duke përfshirë edhe në lidhje me grupet e referuara në nenin 6 të Konventës.

IV. UDHËZIMET, TRAJNIMET DHE RRIJTJA E NDËRGJEGJËSIMIT

1.23 Anëtarët duhet të financojnë, zhvillojnë, zbatojnë dhe shpërndajnë, sipas rastit:

a) programe që synojnë trajtimin e faktorëve që rrisin mundësinë e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës, duke përfshirë diskriminimin, abuzimin e marrëdhënieve të pushtetit dhe normat gjinore, kulturore dhe sociale që mbështesin dhunën dhe ngacmimin;

b) udhëzime me përgjegjësi gjinore dhe programe trajnimi për të ndihmuar gjykatësit, inspektorët e punës, oficerët e policisë, prokurorët dhe zyrtarë të tjerë publikë në përmbushjen e mandatit të tyre në lidhje me dhunën dhe



ngacmimin në botën e punës, si dhe për të ndihmuar punëdhënësit dhe punëtorët publikë dhe privatë dhe organizatat e tyre në parandalimin dhe trajtimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës;

c) kodet model të praktikës dhe mjetet e vlerësimit të riskut mbi dhunën dhe ngacmimin në botën e punës, qoftë të përgjithshme ose specifike për sektorin, duke marrë parasysh situatat specifike të punëtorëve dhe personave të tjerë që i përkasin grupeve të përmendura në nenin 6 të Konventës;

d) fushatat publike të rritjes së ndërgjegjësimit në gjuhë të ndryshme të vendit, duke përfshirë ato të punëtorëve migrantë që banojnë në vend, të cilat përçojnë papranueshmërinë e dhunës dhe ngacmimit, në veçanti dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore, trajtojnë qëndrime diskriminuese dhe parandalojnë stigmatizimin e viktimave, ankuesve, dëshmitarëve dhe informatorëve;

e) kurrikulat me përgjegjësi gjinore dhe materialet udhëzuese mbi dhunën dhe ngacmimin, duke përfshirë dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore në të gjitha nivelet e arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe rrethanat;

f) materiale për gazetarët dhe personelin tjetër të mediave mbi dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore, duke përfshirë shkaqet themelore të tij dhe faktorët e riskut në lidhje me pavarësinë e tyre dhe lirinë e shprehjes; dhe

g) fushatat publike që synojnë nxitjen e vendeve të punës të sigurta, të shëndetshme dhe harmonike, pa dhunë dhe ngacmim.

DEKRET

Nr. 13486, datë 21.2.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 13/2022, “Për ratifikimin e konventës 190 ‘Konventa për dhunën dhe ngacmimin’ të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, 1986”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM

Nr. 14/2022

PËR RRËZIMIN E LISTËS SË DYTË NË BLOK TË KANDIDATËVE TË PËRZGJEDHUR PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË DHE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, SIPAS LIGJIT NR. 115/2016, “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të nenit 147, pika 8, të Kushtetutës dhe nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës së dytë në blok të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si më poshtë:

1. Oriona Muçollari

2. Ilir Rusi

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE

Lindita Nikolla

Miraturar në datën 17.2.2022.

**VENDIM
Nr. 15/2022****PËR RRËZIMIN E LISTËS SË DYTË NË
BLOK TË KANDIDATËVE TË
PËRZGJEDHUR PËR ANËTARË TË
KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË NGA TRUPA E
PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË
DREJTËSISË DHE TË SHKOLLËS SË
MAGJISTRATURËS, SIPAS LIGJIT
NR. 115/2016, “PËR ORGANET E
QEVERISJES SË SISTEMIT
TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të Kushtetutës dhe nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës së dytë në blok të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si më poshtë:

1. Mirela Bogdani
2. Yllka Rupa

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 17.2.2022.

**VENDIM
Nr. 16/2022****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 9, pika 4, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Joana Allushi zgjidhet anëtare e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 17.2.2022.

**VENDIM
Nr. 17/2022****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 9, pika 4, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Aurela Bicja zgjidhet anëtare e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 17.2.2022.

**VENDIM
Nr. 18/2022****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI
TË AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 9, pika 4, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Jetmir Halilaj zgjidhet anëtar i Autoritetit të Mediave Audiovizive.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 17.2.2022.

**VENDIM
Nr. 19/2022****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI
TË AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 9, pika 4, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Gjergji Hamiti zgjidhet anëtar i Autoritetit të Mediave Audiovizive.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 17.2.2022.

**VENDIM
Nr. 20/2022****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI
TË AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 9, pika 4, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Desada Metaj zgjidhet anëtare e Autoritetit të Mediave Audiovizive.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 17.2.2022.

**VENDIM
Nr. 21/2022****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI
TË AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 9, pika 4, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Besian Zogaj zgjidhet anëtar i Autoritetit të Mediave Audiovizive.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 17.2.2022.



UDHËZIM

Nr. 6, datë 3.2.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 3743, DATË 10.7.2017, “MBI
MODELET DHE STANDARDET E
BILETAVE TË TRANSPORTIT RRUGOR
TË UDHËTARËVE”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 21/2, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; të pikës 4, të kreut I dhe pikës 3, të kreut III, të vendimit nr. 85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 3743, datë 10.7.2017, “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Në lidhjen 1, bashkëlidhur udhëzimit, modeli “Biletë transport ndërqytetas”, zëvendësohet me modelin “Biletë, në format letër, për transportin rrugor të udhëtarëve në shërbimin ndërqytetas”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletore Zyrtare.

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

**MODEL
BILETË, NË FORMAT LETËR, PËR
TRANSPORTIN RRUGOR TË
UDHËTARËVE NË SHËRBIMIN
NDËRQYTETAS**

Nr. Serial: 			
	Linja		
	Gjatësi e udhëtimit:		
	Data nisjes:	Ora e nisjes:	Vendi:
Emër operatori: Targa e mjetit: Nr. telefoni: Nipt:	Vendi i nisjes: Vendi mbërritjes: Çmimi:	Etiketa Bagazhit: 	

UDHËZIM

Nr. 7, datë 3.2.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË UDHËZIMIN NR. 5627, DATË
18.11.2016, “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE, RREGULLAVE DHE
DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN
E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË
TRANSPORTIN RRUGOR TË
UDHËTARËVE BRENDA VENDIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 5 dhe 17 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 6, pika 5.1 dhe pika 6, ndryshohen me përmbajtjen si më poshtë:

“5.1 Pas plotësimit të kriterëve të parashikuara në këtë udhëzim, për linjat e rregullta ndërqytetëse që janë operuar në mënyrë aktive, licenca për linjën/linjat që ka pasur në zotërim çdo subjekt nga ministria përgjegjëse për transportin rrugor do t'i lëshohet drejtpërdrejt subjektit që e zotëronte atë, nëpërmjet përdorimit të sistemit elektronik e-Transport.

6. Licenca për shërbimet e rregullta të udhëtarëve lëshohet e shoqëruar me numrin e nevojshëm të certifikatave të operimit të mjeteve, kërkuar nga subjekti transportues, që i shërbejnë për të operuar në linjën/at e miratuara. Numri i mjeteve dhe ndryshimi i orareve përcaktohet nga zyra e licencave në bazë të frekuencës së udhëtimeve, distancës së udhëtimit dhe mjeteve rezervë që duhet të ketë subjekti.



Modeli i certifikatës së operimit jepet në lidhjen 4.”.

Neni 2

Në pikën 1.1, të nenit 9, shtohen pikat me përmbajtje si më poshtë:

“f) Vërtetim nga administrata tatimore dhe nga bashkia përkatëse për shlyerjen e detyrimeve tatimore (dokumenti do të gjenerohet nëpërmjet ndërveprimit institucion me institucion nga sistemi i qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik SQDNE);

h) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për administratorin dhe drejtuesin teknik të shoqërisë; (dokumenti do të gjenerohet nëpërmjet ndërveprimit institucion me institucion nga sistemi i qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik SQDNE);

i) Dokument i lëshuar nga gjykata, i cili të vërtetojë se administratori dhe drejtuesi teknik i shoqërisë nuk janë në proces penal.”.

Neni 3

Në nenin 13, mbas pikës 4, shtohet pika 5 me përmbajtjen si më poshtë:

5. “Në rast se personi fizik ose juridik, ndryshon emrin tregtar të vërtetuar me ekstraktin historik të Qendrës Kombëtare të Biznesit ose ndonjë element tjetër të licencës/certifikatës, me kërkesë të titullarit të saj, kryhet zëvendësimi i dokumentit përkatës, duke lëshuar një dublikatë, me të njëjtin afat vlefshmërie dhe me një numër të ri, pas arkivimit përkatësisht të licencës/certifikatës së vjetër.”.

Neni 4

Në nenin 17, paragrafi i parë i shkronjës “b”, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

“b) Kur certifikata bëhet e palexueshme, dëmtohet ose me kërkesë të vetë titullarit të dokumentit, për rastet kur kërkohet ndryshim i ndonjë elementi përbërës së saj.”.

Neni 5

Afatet e licencave dhe certifikatave të operimit të mjeteve, të lëshuara për shërbimin e

rregullt në transportin ndërqytetës të udhëtarëve, shtyhen deri më 31 mars 2022.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

URDHËR Nr. 30, datë 15.2.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”, nenet 22 e vijuese, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për çështjet e mëposhtme:

a) Të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të kësaj çështjeje, si dhe t'i nënshkruajnë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit;



b) Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme;

c) Për nënshkrimin e autorizimeve për dërgimin me shërbim të punonjësve Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme jashtë qendrës së punës brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

5. Urdhri nr. 555, datë 1.11.2021, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

6. Urdhri nr. 15, datë 13.1.2021, “Për delegim kompetencash për procedurat e prokurimit publik”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Olta Xhaçka

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA LAÇI KUNDËR SHQIPËRISË (Kërkesa nr. 28142/17)

VENDIM

Neni 6§1 (civil) – Mosvlerësimi i vazhdueshëm nga ana e gjykatës vendëse i së drejtës për t'u përjashtuar nga taksa e akteve, duke cenuar thelbin e së drejtës për akses në gjykatë – Të meta në funksionimin e Komisionit Shtetëror për Ndihmë Juridike dhe dominimi i mosdashjes nga ana e gjyqtarëve për të bërë përjashtime nga taksa e akteve, sipas konstatimeve nga organet monitorues të Këshillit të Evropës

STRASBURG
19 tetor 2021

Ky vendim do të bëhet i formës së prerë në përputhje me rrethanat e parashikuara në nenin 44§2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Laçi kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur si Kolegj, i përbërë nga:

Georges Ravarani, *krjetar*,
Georgios A. Serghides,
Maria Elósegui,
Darian Pavli,
Anja Seibert-Fohr,
Peeter Roosma,
Frédéric Krenç, *gjyqtarë*,
dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistrare e Seksionit*,

Duke marrë në konsideratë:

Kërkesën (nr. 28142/17) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur më 3 prill 2017 nga shtetasi shqiptar z. Mustafa Laçi, pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa);

Vendimin për të njoftuar qeverinë e Shqipërisë (Qeveria) për kërkesën;

Vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 28 shtator 2021;



Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë.

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me mosshqyrtimin në vijimësi nga ana e gjykatave vendëse të së drejtës së kërkuesit për t'u përjashtuar nga taksa e padisë, si rezultat i së cilës nuk ka nisur ende shqyrtimi i kësaj padie për dëmshpërblim, sipas meritave të çështjes, duke përbërë në këtë mënyrë një kufizim të së drejtës së tij për akses në një gjykatë.

FAKTET

2. Kërkuesi ka lindur në vitin 1968 dhe jeton në Kavajë. Ai u përfaqësua nga z. D. Matlija dhe z. T. Alexandridis, avokatë të cilët e ushtrojnë profesionin e tyre në Tiranë.

3. Qeveria u përfaqësua nga agjentja e saj në atë periudhë, znj. E. Muçaj, dhe, më pas, nga znj. B. Lilo, nga Avokatura e Shtetit.

4. Faktet e çështjes, sipas parashtrimeve të palëve mund të përmbledhen, si më poshtë:

1. PROCEDIMET NË LIDHJE ME PADINË E KËRKUESIT PËR DËMSHPËRBLIM

5. Më 21 shkurt 2011, kërkuesi dhe shtatëdhjetë persona të tjerë paraqitën padi ndaj Ministrisë së Mbrotjtjes dhe shtetit, ku kërkonin kompensim (pa përcaktuar shumën) për dëm monetar dhe jomonetar për humbjen e jetës së familjarëve të tyre gjatë një shpërthimi në një objekt për çmontimin e municionit, menaxhimin e të cilit autoritetet ua kanë dhënë kompanive private.

6. Më 27 janar 2021, Gjykata e Rrethit Tiranë i ndau paditë për dëmshpërblim. Më 20 janar 2014, kërkuesi pagoi një shumë fikse për taksën e padisë prej 12,000 ALL (rreth 98 euro), sipas rregullave të brendshëm (shih paragrafin 22 më poshtë). Më 28 shkurt 2014, gjykata u vetëshpall jokompetente për shqyrtimin e padisë së kërkuesit, duke pasur në konsideratë krijimin dhe veprimtarinë e gjykatave administrative, dhe vendosi t'ia referonte çështjen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (Gjykata e Shkallës së Parë). Shuma e kompensimit të pretenduar ishte 32,000,000 ALL (rreth 228,000 euro), dhe taksa e padisë që duhej të paguhej ishte 3 për qind i kësaj shume, që është 960,000 ALL (rreth 6,840 euro).

7. Më 6 janar 2015, kërkuesi, i cili ishte i papunë dhe jetonte me një pension mujor prej 8,000 ALL (rreth 57 euro), i kërkoi Komisionit Shtetëror për Ndihmë Juridike (KSHNJ) një formular aplikimi

për të kërkuar ndihmë juridike, në formën e përjashtimit nga pagesa e taksës së padisë, për shkak të varfërisë së tij. Kërkesa nuk mori përgjigje.

8. Në vijim të kërkesës së kërkuesit për t'u përjashtuar nga taksa e padisë, Gjykata e Shkallës së Parë, e rrëzoi këtë kërkesë gjatë një seance paraprake, në mbështetje të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC) për moskorrigjimin e të metave të padisë. Më 20 nëntor 2014, përfaqësuesi i kërkuesit kërkoi një reduktim të shumës së kompensimit të pretenduar. Nuk rezultoi që gjykata ta ketë shqyrtuar këtë kërkesë.

9. Më 20 janar 2015, Gjykata e Shkallës së Parë ia ktheu padinë kërkuesit pa ndërmarrë asnjë veprim, duke deklaruar se ai nuk kishte korrigjuar të metat e padisë, më konkretisht shlyerjen e plotë të taksës së padisë dhe tarifave të ekspertit, brenda afatit të përcaktuar. Më tej, gjykata parashtrroi se ligji për taksën në fjalë nuk parashikonte në mënyrë eksplicite përjashtimin nga pagesa e taksës së padisë dhe tarifave për ekspertët, edhe pse me anë të paraqitjes së dokumenteve mbështetëse, kërkuesi kishte treguar se nuk mund të shlyente taksën e padisë. Më 26 janar 2015, kërkuesi apeloj këtë vendim.

10. Më 21 dhjetor 2017, Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë (Gjykata Administrative e Apelit) e prishi vendimin dhe e ktheu çështjen në Gjykatën e Shkallës së Parë, duke rekomanduar që: të përcaktohej vlera e padisë dhe shuma e taksës së padisë që do të duhej të paguhej; të merrej një vendim i ndërmjetëm ku të përcaktohej se cila palë do të paguante kostot; dhe të orientohej kërkuesi që të kërkonte ndihmë juridike në formën e përjashtimit nga pagesa e taksës së padisë, në mbështetje të ligjit për ndihmën juridike të vitit 2008. Në rast të një refuzimi apo të një mospërgjigjeje nga ana e KSHNJ-së, Gjykata e Shkallës së Parë do të duhej të vihej në lëvizje dhe të vlerësonte nëse kërkuesi ishte i klasifikueshëm për marrjen e ndihmës juridike, në përputhje me nenin 21(1) dhe (2) dhe nenin 13(1)(c) të ligjit për ndihmë juridike të vitit 2008. Nëse Gjykata e Shkallës së Parë arrinte në përfundimin se kërkuesi nuk përmbushte kërkesat statutorë për të përfituar ndihmë juridike, ajo mund ta kthente padinë për mospagim të taksës së padisë, në përputhje e nenet 25(a) dhe 21(1) të ligjit për gjykatat administrative. Nga ana tjetër, mosshlyerja e tarifave të ekspertëve nuk përbënte arsye për ta konsideruar padinë me të



meta, sepse gjykata mund të lëshonte një urdhër për nxjerrjen e detyrueshme të shpenzimeve, në përputhje me nenin 105 të KPC-së (shih paragrafin 17 më poshtë).

11. Më 22 janar 2018, Ministria e Mbrojtjes, e cila ishte në cilësinë e të paditurit gjatë procedimeve, paraqiti një ankesë në Gjykatën e Lartë, për të cilën rezultoi se procedimet janë ende pezull. Ankesa nuk kundërshtonte mungesën e mjeteve financiare të kërkuarit, por theksonte se Gjykata e Shkallës së Parë kishte interpretuar dhe zbatuar në mënyrë korrekte dispozitat përkatëse në lidhje me kërkesën e tij për përjashtim.

II. SHKRESA E AUTORITETEVE PËR KËRKUESIN

12. Në vijim të rezultatit të padisë së kërkuarit për dëmshpërblim përpara Gjykatës së Shkallës së Parë, më 19 shkurt 2015, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë (Ministria) informoi avokatin e kërkuarit (në lidhje me një çështje tjetër), se ende nuk ishte përgatitur një formular aplikimi për të kërkuar përjashtim nga taksa e padisë dhe se do të duhej të miratoheshin një sërë aktesh rregullatore përpara se KSHNJ-ja të mund ta ofronte një formular të tillë. Gjithashtu, Ministria shpjegoi se KSHNJ-ja, në disa raste, mund ta shtynte shlyerjen e taksës së padisë ose të lejonte që pagesa të bëhej në disa këste. Së fundmi, Ministria deklaronte se në mungesë të një vendimi nga KSHNJ-ja, brenda dhjetë ditëve, gjykata përkatëse mund të ofronte ndihmë juridike në një nga format e parashikuara nga ligji, në rast se përmbusheshin kërkesat statutores.

KUADRI DHE PRAKTIKA LIGJORE PËRKATËSE

I. LIGJI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME

A. Kodi i Procedurës Civile (KPC)

13. Neni 104, i cili u shfuqizua në vitin 2017, parashikonte se taksa mbi aktet përcaktohej bazuar në vlerën e padisë, e cila paraqitej nga paditësi. Megjithatë, vetë gjykata mund të përcaktonte vlerën e padisë, nëse kishte dyshime të qarta për shumën e përcaktuar nga paditësi, i cili, si rregull, kishte përgjegjësinë të paguante taksën e akteve.

14. Neni 105(b), i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2001, parashikon se individët, të cilët përjashtohen nga pagesa e taksës së akteve, do të përjashtohen nga pagesa e kostove dhe e shpenzimeve të tjera.

15. Sipas neneve 102 dhe 156, taksa e akteve duhet të paguhet në momentin, kur paraqitet një

padi. Në rastin kur kjo taksa nuk paguhet, një gjyqtar i vetëm e kthen padinë te paditësi pa ndërmarrë asnjë veprim tjetër, në mbështetje të nenit 154(a), duke përcaktuar korrigjimin e të metave brenda afatit kohor të parashikuar. Ndaj këtij vendimi mund të paraqitet një ankesë e posaçme.

16. Sipas nenit 158(a), gjykata, në një seancë paraprake, mund të vendosë për përjashtimin e paditësit nga pagesa e taksës së akteve në çështjet e parashikuara nga ligji. Në një rast të tillë, neni 106 parashikon se tarifat gjyqësore do të mbulohen nga i pandehuri deri në masën e përcaktuar nga gjykata.

17. Sipas nenit 105, tarifat gjyqësore duhet të paguhen paraprakisht nga pala, e cila kërkon një raport të ekspertëve. Megjithatë, gjykata mund të urdhërojë palën tjetër të paguajë tarifat për ekspertët ose mund të urdhërojë që këto tarifa të ndahen midis të gjitha palëve në procedim, nëse një gjë e tillë kushtëzohet nga rrethanat e çështjes dhe nga situata financiare e palëve.

B. Ligji për gjykatat administrative

18. Neni 25 i ligjit për gjykatat administrative parashikon se gjyqtari kryesues ndërmerr një sërë veprimesh brenda shtatë ditësh nga data e paraqitjes së padisë, të tilla si: kërkesa që i bëhet paditësit për të plotësuar mungesat në padi brenda dhjetë ditëve, të vendosë për paraqitjen e një raporti të përgatitur nga ekspertët, në rastin kur ka nevojë për informacione specifike, si edhe një sërë veprimesh të tjera të parashikuara në nenin 158(a) të KPC-së. Këto veprime ndërmerren me anë të vendimeve të ndërmjetme. Mosmarrja pjesë e palëve në veprimet paraprake nuk përbën shkak që çështja të pushohet, edhe nëse palët thirren dhe njoftohen rregullisht.

C. Ligji për ndihmën juridike i vitit 2008, i ndryshuar (ligji nr. 10039 i datës 22 dhjetor 2008, i ndryshuar me ligjet nr. 143/2013 dhe 77/2014)

19. Ligji për ndihmën juridike i vitit 2008 ishte në fuqi deri më 1 qershor 2018, kur u shfuqizua nga ligji për ndihmën juridike i vitit 2017 (ligji nr. 111 i datës 14 dhjetor 2017). Neni 11 parashikon dy lloje të ndihmës juridike: ndihma juridike parësore (që ka të bëjë me informacionet për legjislacionin dhe sistemin ligjor, të drejtat dhe detyrimet e individëve, dhe ndihmën për hartimin e dokumenteve ligjore), dhe ndihma juridike dytësore (që ka të bëjë me këshillimin ligjor dhe



përfaqësimin në procedimet penale, civile dhe administrative). Sipas nenit 12, i cili u ndryshua në vitin 2013, ndihma juridike falas mund të ofrohet edhe në formën e përjashtimit nga pagesa e taksës së akteve dhe nga kostot dhe shpenzimet e tjera.

20. Ligji për ndihmën juridike i vitit 2008 parashikonte themelimin e KSHNJ-së, i cili ishte përgjegjës, midis të tjerash, për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë juridike (nenet 6 dhe 10). Sipas nenit 16(4) dhe (6), ndryshuar në vitin 2014, kërkesat për ndihmë juridike në formën e përjashtimit nga pagesa e taksës së akteve duhej të bëheshin duke përdorur një formular të posaçëm për aplikim. neni 21(1), i cili hyri në fuqi në vitin 2013, parashikonte se KSHNJ-ja do të duhej t'i shqyrtonte kërkesat për ndihmë juridike në formën e përjashtimit nga tarifa e taksës së akteve brenda dhjetë ditësh nga dita e marrjes së kërkesës. Nëse KSHNJ-ja nuk merrte një vendim ose e rrëzonte kërkesën, gjykata, në një seancë paraprake, do të mund të vendoste për përjashtimin e paditësit nga tarifa e taksës së akteve dhe nga kostot dhe shpenzimet e tjera, në rast se përmbusheshin kushtet sipas nenit 13(1)(c). Nëse KSHNJ-ja vendoste se paditësi nuk kishte mundësi të paguante taksën e akteve, për shkak të situatës së tij ose të saj financiare, KSHNJ-ja mund të urdhëronte që pagesa të shtyhej ose të bëhej me këste, edhe kur nuk përmbusheshin kushtet e parashikuara në nenin 13(1).

21. Neni 13(1)(c), i ndryshuar në vitin 2014, parashikonte se një person mund të përfitonte ndihmë juridike falas, nëse ai ose ajo nuk kishte mjete financiare të mjaftueshme për të paguar taksën e akteve, dhe ishte përfitues i ndihmës sociale ose përmbushte kërkesat për ta marrë një ndihmë të tillë, ose ishte viktimë e dhunës në familje ose e trafikimit njerëzor.

D. Ligji për taksat kombëtare (ligji nr. 9975 i datës 28 korrik 2008, i ndryshuar)

22. Ligji për taksat kombëtare parashikon, midis të tjerash, llojet e taksave dhe të tarifave të zbatueshme në vend, si edhe procedurat për përlogaritjen e tyre. Neni 11 parashikonte pagesën e tarifave të shërbimit, të tilla si tarifat gjyqësore, të cilat do të përcaktoheshin me anë të një urdhri të përbashkët të ministrit të Financave dhe të autoriteteve përkatëse shtetërore. Sipas nenit 11, një udhëzim për një praktikë të përbashkët nga ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave

(udhëzimi nr. 13, i datës 12 shkurt 2009), i ndryshuar në vitin 2010, parashikonte se taksa e akteve për një padi për dëmshpërblim të vlerës, e cila ishte më pak se 100,000 ALL (rreth 714 euro), ishte 12,000 ALL. Nëse vlera e padisë kalonte vlerën 100,000 ALL, taksa e aktit do të ishte 3% e shumës së pretenduar.

23. Në vitin 2010, hyri në fuqi një dispozitë e re statutore, e cila parashikonte përjashtimin nga shlyerja e disa tarifave të shërbimeve për kategori të caktuara individësh (ligji nr. 10280, i datës 20 maj 2010). Megjithatë, nuk kishte asnjë dispozitë për përjashtimin nga tarifat gjyqësore.

E. Praktika gjyqësore e brendshme

1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 7/2013

24. Në datë 27 shkurt 2013, përpara miratimit të ndryshimeve të viteve 2013 dhe 2014 në ligjin për ndihmën juridike, Gjykata Kushtetuese vendosi me shumicë se respektimi i kërkesës sipas ligjit vendës për shlyerjen e taksës së akteve në kohën e paraqitjes së padisë, edhe nga personat pa mjete financiare, nuk përbënte një shkelje të së drejtës së individit për akses në gjykatë. Ajo theksonte, se një paditës, i cili paraqiste një padi kërkohej që të paguante paraprakisht tarifën e akteve, si një përqindje e vlerës së padisë. Një gjyqtar i zakonshëm, në referim të rrethanave të çështjes dhe të situatës financiare të paditësit, mund të vendoste, rast pas rasti, ta përjashtonte atë nga detyrimi për të paguar taksën e akteve për të garantuar respektimin e së drejtës për akses në gjykatë. Në një rast të tillë, taksa e akteve do të paguhej nga buxheti i shtetit. Në vijim, Gjykata Kushtetuese përcaktonte se KSHNJ-ja do të duhej të ofronte ndihmë juridike për kategori të caktuara individësh, në përputhje me ligjin për ndihmën juridike të vitit 2008.

25. Opinioni kundërshtues përcaktonte se ishte shkelur e drejta e individit për akses në gjykatë, duke iu referuar kërkesës për të paguar taksën e akteve, sepse legjislacioni i brendshëm nuk parashikonte përjashtim nga pagesa e taksës së akteve për personat pa mjete financiare. Në të nënvizohej, se kërkesa për të paguar taksën e akteve ishte *sine qua non* për vijueshmërinë e procedimeve. Gjithashtu, nënvizohej se interpretimi që u bënte shumica parashikimeve të KPC-së dhe ligjit për ndihmën juridike linte hapësirë për arbitraritet në mungesë të një kuadri të qartë ligjor për kriteret për përjashtim nga taksa.



2. Vendimet e gjykatave më të ulëta

26. Në vërejtjet e paraqitura me shkrim, Qeveria parashtrroi vendimet e mëposhtme të gjykatave vendëse për përjashtimin nga pagesa e tarifave gjyqësore. Më 26 mars 2015, në një çështje të ngjashme për dhënien e dëmshpërblimit monetar dhe jomonetar për humbjen e jetës së familjarëve të paditësve, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, pasi shqyrtoi pretendimin për dëmshpërblim, në mbështetje të meritave të çështjes, vendosi se taksa e akteve dhe kostot dhe shpenzimet të paguara nga paditësit me paraqitjen e padisë, do të mbuloheshin nga të paditurit, të cilët ishin organe shtetërore, në mbështetje të – *inter alia* – neneve 102 dhe 106 të KPC-së.

27. Më 18 tetor 2018, në një seancë paraprake gjatë procedimeve, në lidhje me një padi për pagesën e dëmshpërblimeve monetare dhe jomonetare, gjyqtari i vetëm i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë pranoi kërkesën për përjashtimin nga taksa e akteve, për shkak të varfërisë së të paditurit, sipas neneve 104 dhe 158(a) të KPC-së.

28. Më 25 shtator 2019, Gjykata e Rrethit Tiranë pranoi kërkesën për ndihmë juridike në formën e përfaqësimit në procedimet civile, sipas ligjit për ndihmën juridike 2017, sepse pensioni mujor (që merrej për shkak të moshës) i të paditurit ishte më i ulët se sa të ardhurat minimale mujore të përcaktuara nga Qeveria.

29. Më 1 nëntor 2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë pranoi kërkesën e paditësit për përjashtim nga taksa e akteve, sepse ai përmbushte kërkesat statutores në mbështetje të ligjit për ndihmën ligjore të vitit 2017, duke qenë se të ardhurat e tij ishte një pension për aftësi të kufizuara.

30. Më 23 dhjetor 2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë pranoi kërkesën për ndihmë juridike në formën e përfaqësimit në procedimet administrative, sipas ligjit për ndihmën juridike të vitit 2017, sepse të ardhurat mujore të paditësit ishin më të ulëta se sa të ardhurat minimale mujore të përcaktuara nga Qeveria.

II. MATERIALI I KËSHILLIT TË EVROPËS

A. Komisioneri për të drejtat e njeriut

31. Pas vizitës së tij në Shqipëri nga data 23 deri në 27 shtator 2013, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut (Komisioneri) shprehu shqetësime në lidhje

me tarifat e tepërta gjyqësore dhe u shpreh se gjyqtarët e gjykatave të rrethit dhe të apelit duhej të kishin udhëzime të qarta, në lidhje me zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 7/2013 për çështjen në fjalë, e cila, sipas këndvështrimit të tij, mund të trajtohej nga Gjykata e Lartë në konsultim të ngushtë me Gjykatën Kushtetuese (shih Raportin e KomDH (2014)1).

32. Komisioneri vuri në dukje shqetësimet e shprehura nga Avokati i Popullit, se vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk parashikonte indicie të qarta, se cila do të ishte baza ligjore për përjashtimin nga tarifat gjyqësore, duke qenë se ekzistonte një detyrim i qartë ligjor për pagesën paraprakisht të taksës së akteve dhe përjashtimet nga kjo pagesë ishin raste përjashtimore. Komisioneri iu referua një raporti tjetër në të cilin ishte konstatuar se nuk ekzistonte asnjë mundësi, që gjykatat të reduktonin tarifat gjyqësore në rrethana të veçanta, duke përfshirë edhe rastet e pamundësisë për të paguar, me përjashtim të rasteve kur personat i përkisnin një kategorie specifike, që përjashtohej nga taksat (më konkretisht, nëse provonin se ishin përfitues të ndihmës sociale ose përmbushnin kërkesat për ta përfituar një ndihmë të tillë; ose ishin viktimat të dhunës në familje ose të trafikimit të qenieve njerëzore).

33. Në shkresën vijuese të datës 11 mars 2016 (KomDH (2016)44) drejtuar ministrit të Drejtësisë të Shqipërisë së asaj periudhe, Komisioneri përsëriste shqetësimet e tij për mungesën e zbatimit efikas të ligjit për ndihmë juridike 2008, i cili vijonte të krijonte pengesa në aksesin në drejtësi për grupe të caktuara vulnerabël. Ai theksonte të metat në funksionimin e KSHNJ-së, gjë e cila vërtetohej me numrin e ulët të kërkesave për ndihmë juridike që ky komision merrte.

34. Në vijim, Komisioneri shprehte shqetësimet, se: “raportohet se gjyqtarët ngurrnin/jnë të përjashtojnë personat me vështirësi financiare nga tarifat gjyqësore. Për pasojë, pak persona janë përjashtuar nga këto tarifa”. Sipas tij, ndryshimet e vitit 2013 në ligjin për ndihmën juridike, të cilat e ngarkonin KSHNJ-në me detyrën për të bërë përjashtime në pagesën e taksës së akteve dhe nga kostot dhe shpenzimet e tjera nën disa kushte të caktuara, nuk kishin dhënë frute, duke qenë se, sipas raportimeve askush nuk kishte përfituar nga ajo mundësi.



B. Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës

35. Në raportin e ciklit të pestë monitorues për Shqipërinë, i cili trajtonte situatën në vend deri më 10 dhjetor 2014, Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (KERI) shprehte shqetësime në lidhje me mungesën e efikasitetit të sistemit për ndihmën juridike falas. Personat në nevojë për ndihmë juridike nuk kishin mundësi të paraqisnin dokumentet e nevojshme të detajuar për të aplikuar për ndihmë juridike falas pranë KSHNJ-së, i cili trajtonte një numër të vogël çështjesh në një vit, dhe buxheti i tij ishte shumë i vogël për të punësuar avokatë për të gjithë personat në nevojë.

Pavarësisht vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 7/2013, KERI raportonte, se: “sidoqoftë, gjyqtarët ishin ngurrues në përdorimin e pushtetit të tyre”, për të përjashtuar paditësit nga tarifa e akteve. KERI priste që gjyqtarët do të fillonin ta përdornin atë pushtet dhe ishte i mendimit se autoritetet do të duhej të garantonin se një avokat do të caktohej për paditësit me anë të sistemit të ndihmës juridike në çështjet e diskriminimit të konsideruara si urgjente.

LIGJI

1. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6§1 TË KONVENTËS

36. Kërkuesi u ankua se mosshqyrtimi i meritave të padisë së tij për dëmshpërblim nga ana e gjykatave vendëse për mospagimin prej tij të taksës së akteve përbënte një kufizim të pajustificuar të së drejtës së tij për akses në një gjykatë në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës, pjesa përkatëse e së cilës parashikon, si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ..., çdo person ka të drejtë për një ... seancë dëgjimore brenda një afati të arsyeshëm nga [një] ... gjykatë ...”.

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

37. Qeveria parashtroi se kërkuesi nuk kishte më interes që ta ndiqte çështjen e tij përpara Gjykatës, përderisa vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit kishte qenë në favor të tij. Ai vendim konstatonte se sistemi vendës ofronte mjaftueshëm mjete, të cilat ishin efikase si në teori edhe në praktikë.

38. Gjithashtu, Qeveria parashtroi se kërkuesi nuk kishte respektuar afatin gjashtëmujor, pa dhënë asnjë detaj. Në vijim, Qeveria shprehej se ankesa

ishte e parakohshme, duke qenë se kërkuesi e kishte paraqitur kërkesën në Gjykatë, përpara dhënies së vendimit nga Gjykata Kushtetuese Administrative e Apelit. Në fund, Qeveria ishte e mendimit se ankesa nuk mbështetej në fakte.

39. Kërkuesi parashtroi, se Qeveria nuk kishte deklaruar periudhën prej së cilës kishte nisur të përllogaritej afati gjashtëmujor. Në çdo rast, kërkesa e tij nuk ishte e parakohshme, fillimisht, ai e kishte paraqitur padinë pranë gjykatave vendëse në vitin 2011 dhe, deri më sot nuk kishte marrë ende një vendim për këtë çështje. Për pasojë, sipas tij, gjykatat vendëse nuk kishin ofruar mjete praktike dhe efikase për përjashtimin e tij nga detyrimi për të paguar tarifat gjyqësore.

2. Vlerësimi i Gjykatës

40. Palët nuk debatuan për zbatueshmërinë e nenit 6 gjatë procedimeve në fjalë. Duke qenë se procedimet kishin të bënin me kërkesën e kërkuesit për dëmshpërblim dhe në këtë mënyrë lidheshin me “përcaktimin e të drejtave civile”, për qëllime të atij neni, Gjykata nuk sheh ndonjë arsye për të vendosur ndryshëm (shih, për shembull, *Kreuz kundër Polonisë* nr. 28249/95, §35, 19.6.2001).

41. Fillimisht, Gjykata do të adresojë objeksionin e Qeverisë, se duke pasur parasysh vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit të datës 21 dhjetor 2017, kërkuesi e humbi statusin e tij të viktimës dhe nuk ka më interes në ndjekjen e kësaj kërkesë përpara Gjykatës. Gjykata përcakton, se, në parim, edhe një vendim i favorshëm për një kërkues nuk mjafton për ta privuar atë nga statusi i tij/saj i “viktimës”, sipas nenit 34 të Konventës, në rast se autoritetet kombëtare nuk e kanë njohur, shprehimisht apo në mënyrë substanciale dhe, më pas, janë korrigjuar për shkeljen e Konventës (shih, për shembull, *Scordino kundër Italisë (nr. 1)* [DHM] nr. 36813/97, §180, GJEDNJ 2006-V). Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Apelit nuk njohu mungesën e aksesit në një gjykatë të kërkuesit, por ia kaloi çështjen Gjykatës së Shkallës së Parë për të shqyrtuar kërkesën për ndihmë juridike në formën e përjashtimit nga tarifa gjyqësore. Gjithashtu, për kërkuesin nuk u bë asnjë korrigjim, duke qenë se vlerësimi i rrethanave të tij personale nuk është bërë ende. Faktikisht, gjykatat vendëse nuk kanë marrë asnjë vendim në lidhje me pretendimin e kërkuesit për dëmshpërblim, pasi deri më 22 janar 2018, apelimi në kasacion i palës kundërshtare, për



çështjen e ndërmjetme të shlyerjes së taksës së akteve, rezulton të jetë ende pezull përpara Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, Gjykata është e mendimit se, për qëllime të nenit 34 të Konventës, kërkuesi nuk ka humbur statusin e tij të viktimës, dhe kundërshtimi i Qeverisë, në lidhje me këtë aspekt duhet të rrëzohet.

42. Në vijim, Gjykata gjykon se, pavarësisht objeksionit të Qeverisë për respektimin nga ana e kërkuetit të afatit kohor gjashtëmujor, nuk ka dalë asnjë problematikë, në lidhje me procedimet që janë pezull përpara gjykatave vendëse. Në lidhje me kundërshtimin e Qeverisë, se ankesa ishte e parakohshme, Gjykata vëren se kërkuesi paraqiti një padi për dëmshpërblim për humbjen e jetës së bashkëshortes së tij, më 21 shkurt 2011 (shih paragrafin 5 më sipër), dhe se ajo padi nuk është shqyrtuar ende në themel nga gjykatat vendëse, pavarësisht një sërë hapash të ndërmarrë nga ai në lidhje me këtë aspekt. Për sa i përket faktit se kanë kaluar më shumë se dhjetë vjet që nga dorëzimi i padisë në gjykatat vendëse, pa një vendim përfundimtar për meritat e çështjes, Gjykata mendon se kjo problematikë është edhe esenca e ankesës së kërkuetit për një kufizim të pajustificuar të së drejtës së tij për akses në një gjykatë dhe duhet t'i shtohet shqyrtimit të meritave të ankesës.

43. Gjithashtu, ankesa ngre problematika serioze, që kanë të bëjnë me faktin dhe ligjin sipas Konventës, vendimi për të cilat kërkon shqyrtimin e meritave të çështjes. Sipas nenit 35§3(a) të Konventës, ankesa nuk është e pambështetur në fakte dhe nuk është e papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

a) Kërkuesi

44. Kërkuesi theksoi se sistemi vendës nuk ofronte mjete efikase për ankesën e tij, në lidhje me Konventën. Në këtë aspekt, vendimet e gjykatës vendëse të garantuara nga Qeveria ishin thjesht provë e pasigurisë, që shoqëronte çështjen e përjashtimeve nga taksa të akteve dhe nga kostot dhe shpenzimet në përgjithësi.

45. Kërkuesi u shpreh se ai ishte penguar që çështja e tij të shqyrtohej nga gjykatat vendëse, duke iu referuar pamundësisë së tij financiare për të paguar taksën e akteve. Faktikisht, Gjykata e Shkallës së Parë, e cila kishte njohur varfërinë e tij,

e kishte pushuar çështjen duke iu referuar vetëm mospagesës së taksës. Në apelin e tij në kasacion, Ministria e Mbrojtjes nuk e kishte kundërshtuar gjendjen e varfër të kërkuetit, por kishte argumentuar se Gjykata e Shkallës së Parë kishte zbatuar dhe interpretuar në mënyrë korrekte ligjin vendës, duke mos e përjashtuar atë nga detyrimi për të paguar taksën e akteve.

46. Kërkuesi nënvizoi se kufizimi i së drejtës së tij për akses në një gjykatë kishte qenë thjesht dhe vetëm i një natyre financiare, pa pasur lidhje me meritat e padisë ose me aspektet e suksesit të saj. Gjithashtu, mungesa e një udhëzimi të qartë legjislativ dhe rregullator, në lidhje me modalitetet e garantimit të përjashtimit nga taksa e akteve, siç parashikohet në opinionin kundërshtues të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 7/2013 (shih paragrafin 25 më sipër), i bëri gjyqtarët ngurrues në pranimin e një kërkesë të tillë.

47. Në fund, kërkuesi parashtroi se, ndryshe nga pretendimet e Qeverisë se të drejtat e tij ishin garantuar me anë të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, ai nuk ishte përjashtuar ende nga detyrimi për të paguar tarifën gjyqësore. Gjykata e apelit nuk kishte vendosur ta përjashtonte nga ky detyrim, por në vend të vepronte kështu, gjykata e kishte dërguar çështjen në gjykatën e shkallës së parë me udhëzimin, që kjo gjykatë të shqyrtonte kërkesën e kërkuetit për përjashtim. Në vijim, kërkuesi parashtroi, se vonesa në shqyrtimin e meritave të padisë së tij për dëmshpërblim, e kishte bërë garantimin e së drejtës së tij për akses në gjykatë teorike dhe iluzioniste. Kjo nënkuptonte se esenca e së drejtës së tij për akses në një gjykatë ishte cenuar.

b) Qeveria

48. Qeveria theksoi se pagesa paraprake e taksës së akteve ishte imperative për të garantuar mirëfunksionimin e procesit gjyqësor dhe për t'i shërbyer interesit publik.

49. Gjithashtu, Qeveria parashtroi se e drejta e kërkuetit për akses në një gjykatë ishte njohur nga gjykatat vendëse, duke qenë se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit kishte përfshirë të gjitha parimet e artikuluar në praktikën gjyqësore të Gjykatës. Ligji i brendshëm dhe praktika gjyqësore, duke përfshirë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 7/2013, tregonte se sistemi ofronte mjete efikase dhe se argumentimi nga ana e ankuetit se aksesi i tij në një gjykatë ishte kufizuar, për shkak të



pamundësisë së tij për të paguar taksën e akteve nuk mbështetej në fakte.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parimet e përgjithshme

50. Gjykata thekson se e drejta për akses në një gjykatë nuk është absolute, por mund të bëhet objekt i kufizimeve; këto nënkuptohen përderisa e drejta për akses nga vetë natyra e saj kërkon rregullimin nga ana e shtetit, rregullim i cili mund të variojë në kohë dhe në vend, sipas nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve. Kufizimet nuk duhet që të kufizojnë aksesin e mbetur për individët, në atë mënyrë apo në atë nivel, që të cenohet çdo aspekt i së drejtës. Gjithashtu, një kufizim nuk është në përputhje me nenin 6§1 të Konventës, nëse nuk ndjek një synim legjitim dhe nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e propocionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (shih *Pasquini kundër San Marinos* nr. 50956/16, §156, 2 maj 2019).

51. Gjykata ka vendosur se duke qenë se kërkesa për të paguar tarifën gjyqësore në gjykatat civile, në lidhje me paditë për të cilat këto gjykata duhet të japin një vendim, nuk mund të konsiderohet si kufizim i së drejtës për akses në një gjykatë, gjë e cila është në mosrespektim *per se* të nenit 6§1 të Konventës (shih *Stankov kundër Bullgarisë* nr. 68490/01, §52, 12 korrik 2007), shuma e tarifave të vlerësuara në bazë të rrethanave të një çështjeje të caktuar, duke përfshirë edhe mundësinë e kërkuarit për t'i paguar ato, dhe faza e procedimeve në të cilën është vendosur ky kufizim, janë faktorë të cilët janë materialë në përcaktimin nëse një person ka shijuar apo jo të drejtën e tij për akses dhe është "... dëgjuar nga një gjykatë" (shih *Krenz*, cituar më sipër, §60). Gjykata i kushton veçanërisht vëmendje rëndësisë së kufizimit në aksesin e një gjykate të cilat janë krejtësisht të një natyre financiare dhe që nuk lidhen aspak me meritat e padisë apo me perspektivat për suksesin e saj duhet t'i nënshtrohen një shqyrtimi rigoroz nga aspekti i interesave të drejtësisë (shih, midis të tjerash, *Podbielski dhe PPU Polpure kundër Polonisë* nr. 39199/98, §65, 26 korrik 2005; *Teltronic-CATV kundër Polonisë* nr. 48140/99, §61, 10 janar 2006; *Apostol kundër Gjeorgjisë* nr. 40765/02, §60, GJEDNJ 2006-XIV; dhe *Paykar Yev Haghtanak Ltd kundër Armenisë* nr. 21638/03, §45, 20 dhjetor 2007).

52. Gjithashtu, Gjykata i ka konsideruar si të tepruara dhe, për këtë arsye, si cenuese në esencën e së drejtës për akses në gjykatë, tarifën e larta gjyqësore, të cilat nuk justifikoheshin nga situata financiare e kërkuarit, por ishin përlogaritur në bazë të një përqindjeje standarde statutoire të shumës në fjalë gjatë procedimeve (shih *Weissman dhe të tjerët kundër Rumanisë* nr. 63945/00, §§39–42, GJEDNJ 2006-VII (ekstrakte)).

b) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen konkrete

53. Në çështjen konkrete, kërkuari paraqiti një kërkesë për dëmshpërblim për humbjen e jetës së bashkëshortes së tij. Sipas ligjit vendës, atij i kërkohej të paguante një taksë aktesh, e cila përlogaritej në bazë të një përqindjeje standarde, të përcaktuar nga ligji, për shumën e pretenduar. Gjykata nuk ka përjashtuar faktin, se qëllimi i ndjekur nga rregullat e përgjithshme për pagesën dhe mbledhjen e tarifave gjyqësore i shërben interesit të drejtësisë dhe, si i tillë, mund të pranohet të jetë në përputhshmëri me praktikën gjyqësore të Gjykatës (shih *Krenz*, §59, dhe *Weissman dhe të tjerët*, §35, të dy cituar më sipër).

54. Megjithatë, palët nuk kanë diskutuar aspektin, se, për shkak të situatës së tij të dobët financiare, si rezultat i statusit të tij si i papunë, kërkuari nuk ka pasur mundësi të paguante taksën e lartë të akteve, e cila është njëqind e njëzet herë më e lartë se sa pensioni i tij mujor (shih paragrafët 6 dhe 7 më sipër). Aspekti qendror i kësaj çështjeje mbetet nëse autoritetet vendëse kanë bërë një vlerësim për situatën e tij financiare, në përputhje me parashikimet e nenit 6 të Konventës, në mënyrë që detyrimi për të paguar taksën e lartë të akteve të mos cenonte esencën e së drejtës së tij për akses në një gjykatë.

55. Gjykata është shprehur se pala e cila kërkon të përjashtohet nga tarifën gjyqësore duhet të veprojë me kujdesin e nevojshëm, kur i paraqet gjykatave provat, në lidhje me situatën e tij/saj financiare dhe ka detyrimin të bashkëpunojë në mënyrë besnike me gjykatat për çështjen (shih, për shembull, *Elcomp sp. Z.o.o. kundër Polonisë* nr. 37492/05, §41, 19 prill 2011). Në lidhje me këtë aspekt, kërkuari bëri kërkesë pranë KSHNJ-së, pa sukses, në përputhje me parashikimet e Ligjit për Ndihamen Juridike. Kërkesa e tij për përjashtim nga taksa e akteve nuk mori përgjigje. Gjykata thekson të metat në funksionimin e KSHNJ-së që prej



krijimit të saj, të meta të cilat u raportuan nga organet monitoruese të Këshillit të Evropës në vitin 2013 dhe 2014 (shih paragrafët 33 dhe 35 më sipër) dhe u vunë në dukje në një shkresë dërguar kërkuessit nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2015 (shih paragrafin 12 më sipër).

56. Kërkuessi bëri edhe një kërkesë për përjashtim nga taksa e akteve në Gjykatën e Shkallës së Parë, e cila e rrëzoi kërkesën dhe ia ktheu padinë për dëmshpërblim, pa marrë një vendim mbi meritat e çështjes. Gjykata vëren, se, pavarësisht faktit se Gjykata e Shkallës së Parë kishte dokumente mbështetëse nga kërkuessi për situatën e tij të varfër financiare, kjo gjykatë, teksa e pranonte gjendjen e tij të varfër (shih paragrafin 9 më sipër), nuk bëri një vlerësim të rrethanave të tij personale, në përputhje me ato që rezultonin të ishin parashikime të qarta të nenit 21/1, të ligjit për ndihmë juridike. Gjithashtu, gjykata rezulton të mos ketë marrë në konsideratë interpretimin e bërë nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 7/2013.

57. Në këtë aspekt, Gjykata mban në vëmendje situatën që dominon në Shqipëri, në periudhën në fjalë, për të cilën organet monitoruese të Këshillit të Evropës kanë shprehur shqetësime serioze, duke nënvizuar, se: “gjyqtarët ngurrojnë që të përjashtojnë personat me kufizime financiare nga tarifat gjyqësore” (shih paragrafët 34 dhe 35 më sipër). Në vijim, Gjykata gjykon se shuma e taksës së akteve për t’u paguar nga kërkuessi ishte tejet e lartë, duke marrë në konsideratë pensionin mujor që ai merr (shih paragrafin 7 më sipër). Kufizimi në fjalë konstatohet që në fazën fillestare të procedimeve.

58. Pas një apelimi nga ana e kërkuessit, Gjykata Administrative e Apelit prishi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe e dërgoi çështjen te një trupë tjetër brenda së njëjtës gjykatë, duke dhënë një sërë udhëzimesh për t’u marrë në konsideratë. Megjithatë, pas një apelimi në kasacion të paraqitur nga i pandehuri, më konkretisht Ministria e Mbrojtjes, procedimet rezultojnë të jenë pezull përpara Gjykatës së Lartë, që prej vitit 2018. Për pasojë, gjykatat vendëse nuk kanë realizuar ende një vlerësim të individualizuar të situatës financiare të kërkuessit, për të përcaktuar nëse ai duhet të përjashtohet nga taksa e akteve. Shqyrtimi i kërkesës për dëmshpërblim, sipas meritave, nuk ka nisur ende.

59. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se reagimi i kërkuessit për të shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga ligji vendës nuk mund të qortohet. Megjithatë, përpjekjet e tij duket se janë penguar nga efekti kumulativ i të metave në funksionimin e KSHNJ-së dhe mosmiratimit nga ana e tij të rregulloreve zbatuese, nga hezitimi i dukshëm i gjyqtarëve vendës për të përjashtuar personat, me mjete të pamjaftueshme financiare nga taksa e akteve, nga mosvlerësimi i duhur nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë e situatës së tij financiare dhe nga vonesa e madhe në procedimet e kasacionit për çështjen e ndërmjetme përpara Gjykatës së Lartë. Si rezultat, kërkuessi vijon të përballlet me pasiguri, në lidhje me perspektivën që padia e tij për dëmshpërblime paraqitur në vitin 2011 të shqyrtohet në mbështetje të meritave.

60. Aspektet e mësipërme janë të mjaftueshme për të bërë të mundur që Gjykata të arrijë në përfundimin se mosvlerësimi i vazhdueshëm i gjykatave vendëse i aspektit, nëse kërkuessi klasifikohet për përjashtim nga taksa e akteve ka cenuar thelbin e së drejtës së tij për akses në gjykatë.

61. Për këtë arsye, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë (shih, *mutatis mutandis*, *Kutić kundër Kroacisë* nr. 48778/99, §§25–26 dhe 32, GJEDNJ 2002 II) dhe konstaton se është shkelur neni 6§1 i Konventës.

III. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

62. Neni 46 i Konventës paraqitet, si më poshtë:

“1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.”.

63. Neni 41 i Konventës paraqitet si më poshtë:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”.

A. Neni 46

64. Kërkuessi i kërkoi Gjykatës që t’i sugjeronte shtetit të paditur të tërhiqte apelimin e bërë në



kasacion për të mundësuar që procedimet përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të fillonin menjëherë pas vendimit të Gjykatës. Gjithashtu, ai i kërkoj Gjykatës që t'i sugjeronte Qeverisë që të merrte të gjitha masat e nevojshme për të garantuar një gjykim të përsheptuar të meritave të padisë së tij për dëmshpërblim, duke përcaktuar afate kohore për procedimet.

65. Gjykata thekson se konstatimet për një shkelje në vendimet e saj, në thelb, janë deklarative (shih, midis autoriteteve të tjerë, *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) kundër Zvicrës (nr. 2)* [DHM] nr. 32772/02, §61, GJEDNJ 2009, dhe *Ë.D. kundër Belgjikës* nr. 73548/13, §167, 6 shtator 2016). Në përputhje me nenin 46 të Konventës, një konstatim për shkelje e vë shtetin e paditur përpara detyrimit ligjor, që jo vetëm t'u paguajë personave në fjalë shumat e caktuara për kompensim të drejtë, sipas nenit 41, por edhe të përzgjedhë, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose, nëse është me vend, masat individuale për t'u miratuar në urdhrin e saj të brendshëm ligjor, për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe për të korrigjuar sa më shumë të jetë e mundur efektet (shih, midis të tjerash, *Broniowski kundër Polonisë* [DHM] nr. 31443/96, §192, GJEDNJ 2004-V; *Dybaku*, cituar më sipër, §63; dhe *Slawomir Musiał kundër Polonisë* nr. 28300/06, §106, 20 janar 2009).

66. Për sa ka të bëjë me konstatimet e mësipërme, në lidhje me rrethanat specifike të çështjes dhe nevojën për t'i dhënë fund shkeljes së nenit 6§1, dhe për sa ka të bëjë me masat individuale, Gjykata shprehet se gjykata vendëse duhet të garantojnë, me urgjencë, se do të vlerësohet klasifikueshmëria e kërkuarit për t'u përjashtuar nga tarifat gjyqësore, për vonesa të tjera.

67. Sipas ligjit për ndihmën juridike të vitit 2017, i cili shfuqizoi ligjin për ndihmën juridike të vitit 2008, Gjykata nuk është e mendimit, se ka pasur nevojë për masa të përgjithshme. Zbatimi i ligjit për ndihmën juridike 2017, megjithatë, mund të bëhet objekt i shqyrtimit të Gjykatës, veçanërisht, në varësi të kapaciteteve të autoriteteve për të trajtuar kërkesat për ndihmë juridike.

B. Neni 41

1. Dëmi

68. Në pretendimet e tij paraqitur, në mbështetje të rregullës 60, të Rregullores së

Gjykatës, kërkuar argumentonte, se, në rrethanat e tij specifike, konstatimi i një shkeljeje, si kompensim i drejtë i mjaftueshëm nuk do të ishte i përshtatshëm, sepse, fillimisht, çështja pritej të qëndronte përpara Gjykatës së Lartë për një kohë të gjatë, dhe së dyti, edhe pse çështja e dhënies së tarifave gjyqësore ishte zgjidhur në mënyrë të përsheptuar, shqyrtimi i meritave të padisë së tij për dëmshpërblim do të bëhej me vonesë duke marrë parasysh *backlog*-un (dosjet e mbetura pezull) në gjykatat vendëse të të gjitha niveleve.

69. Kërkuar nuk paraqiti pretendime për dëm monetar, por kërkoj 10,000 euro për dëm jomonetar, pasi nuk kishte marrë kompensim nga procedimet vendëse.

70. Qeveria i kundërshtoi pretendimet e kërkuarit, duke nënvizuar se nuk ishin të argumentuara.

71. Gjykata pranon se kërkuar ka vuajtur një dëm jomonetar, i cili nuk është kompensuar mjaftueshëm nga gjetja e një shkeljeje të Konventës. Duke bërë vlerësimin e saj në një bazë të përpjestimuar, Gjykata i jep atij 7,500 euro për këtë çështje.

2. Kostot dhe shpenzimet

72. Kërkuar pretendonte edhe 2,000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra në gjykatat vendëse dhe 3,400 euro për ato të bëra përpara Gjykatës. Ai paraqiti një dokument, i cili kishte një tabelë me kostot dhe shpenzimet e bëra për përfaqësuesit e tij.

73. Qeveria parashtroi se këto pretendime ishin të tepruara dhe të pajustificuara.

74. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një kërkuar ka të drejtën të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet, për aq kohë sa demonstron, se këto kosto dhe shpenzime ishin të nevojshme të bëheshin dhe janë bërë faktikisht dhe janë të arsyeshme sa i përket kuantitetit. Gjykata vëren se kërkuar nuk ka paraqitur një listë të plotë dokumentesh, si për shembull, fatura ose kontrata, në mbështetje të shumës në total të kostove dhe të shpenzimeve të bëra në procedimet vendëse. Megjithatë, Gjykata konstaton se, për sa u përket dokumenteve në dosjen e çështjes, ai do të duhej të kishte kosto dhe shpenzime të bëra gjatë procedimeve si përpara gjykatave vendëse edhe përpara Gjykatës. Në këtë mënyrë, në çështjen në fjalë, duke iu referuar informacioneve të vëna në



dispozicion, Gjykata vendos se është e arsyeshme që kërkuessit t'i jepet shuma prej 3,000 eurosh.

3. *Interesi i papaguar*

75. Gjykata e mendon të përshtatshme, që norma e interesit të papaguar duhet të mbështetet në normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane, shumë së cilës i duhen shtuar edhe tri pikë përqindjeje.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. *Bashkohet* me meritat e objeksionit të Qeverisë, se ankesa ishte e parakohshme dhe e *pushon* atë, pasi ka shqyrtuar meritat.

2. *E deklaron* kërkesën të pranueshme.

3. *Gjykon* se ka pasur një shkelje të nenit 6§1 të Konventës.

4. *Gjykon:*

a) se shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuessit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me nenin 44§2 të Konventës, shumat e mëposhtme, të cilat duhet të konvertohen në monedhën e shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes së pagesës:

i. 7,500 euro (shtatë mijë e pesëqind euro), plus çdo taksë që mund të tarifohet, për dëmin jomonetar;

ii. 3,000 euro (tre mijë euro), plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuessit, për kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i periudhës së sipërpërmendur prej tre muajsh deri në shlyerje interesi të thjeshtë do të paguhet për shumat e mësipërme në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së vonesës në pagesë plus tri pikë përqindjeje.

5. *Pushon* pjesën tjetër të padisë së kërkuessit për kompensim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 19 tetor 2021, sipas rregullës 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

ZËVENDËSREGJISTRARE
Olga Chernishova

KRYETAR
Georges Ravarani

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 7469/17

MR-INTERNACIONAL SHPK
kundër Shqipërisë
(shih tabelën bashkangjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur më 9 dhjetor 2021, si Komision, i përbërë nga:

Dmitry Dedov, *kryetar*,

Peeter Roosma,

Andreas Zünd, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e përkehshme e Seksionit*,

Pasi mori në konsideratë kërkesën e mësipërme të paraqitur më 16 janar 2017,

Pasi mori në konsideratë deklaratën e parashtruar nga Qeveria e paditur, me anë të së cilës i kërkohej Gjykatës të hiqte kërkesën nga lista e çështjeve dhe përgjigjen e kompanisë kërkuese ndaj kësaj deklarate,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë.

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kompanisë kërkuese janë paraqitur në tabelën bashkangjitur. Kompania kërkuese u përfaqësua nga z. F. Caka, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë.

Ankesat e kompanisë kërkuese, në lidhje me moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve të brendshme iu komunikuan qeverisë shqiptare (Qeveria), sipas nenit 6§1 të Konventës. Ankesat, mbështetur në të njëjta fakte, u komunikuan edhe në mbështetje të parashikimeve të tjera të Konventës.

Pas negociatave të pasuksesshme për një zgjidhje miqësore, më 30 shtator 2021, Qeveria parashitroi një deklaratë mbi një zgjidhje të problemeve që lindin nga këto ankesa. Qeveria pranoi moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve të brendshme. Gjithashtu, Qeveria pranoi se autoritetet e brendshme kishin shkelur të drejtat e kompanisë kërkuese të garantuara nga parashikime të tjera të Konventës. Qeveria ofroi t'i paguante kompanisë kërkuese shumën e detajuar në tabelën bashkangjitur dhe e ftonte Gjykatën ta



hiqte kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje të nenit 37§1(c) të Konventës. Shuma do të konvertohej në monedhën e shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes dhe do të duhej të paguhej brenda tre muajve nga data e njohfimit të vendimit të Gjykatës. Në rastin e mospagimit të kësaj shume brenda periudhës së sipërpërmendur prej tre muajsh, Qeveria ndërmerre të paguante interesin e thjeshtë për këtë shumë, nga përfundimi i periudhës për shlyerjen e shumës deri në shlyerjen e saj, në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit plus tri pikë përqindjeje. Pagesa përbën edhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Për këtë arsye, Qeveria i kërkoj Gjykatës që ta hiqte kërkesën nga lista e çështjeve.

Më 23 tetor 2021, kompania kërkuese informoi Gjykatën se binte dakord me kushtet e deklaratës së Qeverisë.

LIGJI

Gjykata konstaton se, në mbështetje të dakordësimit të qartë të kompanisë kërkuese me kushtet e deklaratës së bërë nga Qeveria, çështja

duhet të trajtohet si një zgjidhje miqësore midis palëve.

Për këtë arsye, Gjykata mban në konsideratë zgjidhjen e arritur midis palëve. Gjykata është e bindur se zgjidhja mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut, sipas parashikimit në Konventë dhe protokolleve të saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye për të justifikuar vijimin e shqyrtimit të kërkesës.

Për sa më sipër, është e drejtë që çështja të hiqet nga lista e çështjeve.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime, *Vendos*, ta heqë kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje të nenit 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 13 janar 2022.

ZËVENDËSREGJISTRARE
E PËRKOHSHME
Viktoriya Maradudina

KRYETAR
Dmitry Dedov

SHTOJCË

KËRKESË ME ANË TË SË CILËS PARASHTROHET ANKESA SIPAS NENIT 6§1 TË KONVENTËS
(MOSZBATIM OSE ZBATIM I VONUAR I VENDIMEVE TË BRENDSHME)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i regjistrimit	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Ankesa të tjera në mbështetje të praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së dakordësimit të kërkuarit	Shuma e dhënë për dëmin jomonetar dhe kostot dhe shpenzimet për kërkuar (në euro) ¹
7469/17 16.1.2017	MR- INTERNACIONAL SHPK 1999	Caka Ferdinand TIRANA	Neni 13 – mungesa e mjeteve efikase në ligjin e brendshëm për moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve të brendshme Prot. 1, neni 1 – ndërhyrje në gëzimin e paqte të pronës, për shkak të zbatimit të vonuar të vendimeve të formës së prerë	30.9.2021	3.11.2021	2.750

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuarit.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë